



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE VLORË

Nr. 384/6 Prot

Vlorë, 15.09.2026

Lënda: Shpallje për subjektin ""USAlb & Co"" SHPK, me NIPT M22723401C

DREJTUAR: SUBJEKTIT ""USAlb & Co"" SHPK, ME NIPT M22723401C

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Vlorë, Rajoni II, ka kryer inspektim në subjektin ""USAlb & Co"" SHPK, me nipt M22723401C, me adresë "Lagja "1 Maj", Rruga : "Unaza e Re"; Zona Kadastrale 2890, Nr i Pasurisë 21/24, Vol 14, Fq 85; Patos" dhe në përfundim të procesit të inspektimit në mbështetje të ligjit 9634, datë 30.10.2006 "Për Inspektimin në Punë" i ndryshuar, është marrë Procesverbali Inspektimit me Nr. ISHPSHSH-VL-2024-000853-2, datë 27/08/2026, ku ndaj subjektit janë ndërmarrë këto gjetje:

1. Pika 5, neni 94, Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Komente: Subjekti nuk paraqi një dokument ku të faktonte pagesën e pushimeve vjetore të paguara.

2. Pika 1, neni 116, Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Komente: Subjekti nuk paraqiti një dokument ku faktonte pagesën e pagave për znj. Majlinda Meduli

3. Neni 120, Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Komente: Në rast të pagesës së pagës me vonesë, përqindja vjetore e interesit në rast vonese është jo më pak se 10 për qind e shumës së papaguar dhe në të gjitha rastet jo më pak se 150 për qind e inflacionit gjatë periudhës së vonesës.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji 99, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë" njoftimi i subjektit për këtë Procesverbal Inspektimi nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë.

Bazuar në nenin 162 i Ligjit Nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ISHPSHSH Vlorë, Rajoni II, ka vendosur njoftimin e subjektit ""USAlb & Co"" SHPK, me nipt NIPT M22723401C, dhe adresë "Lagja "1 Maj", Rruga : "Unaza e Re"; Zona Kadastrale 2890, Nr i Pasurisë 21/24, Vol 14, Fq 85; Patos" për njohjen me këtë Procesverbal të Inspektimit me anë të shpalljes së këtij njoftimi duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së Vlorë, Rajoni II, Sektori Inspektimit Fier, me adresë "Lagjia 16 Prilli, Rruga" Llukan Toska", pranë ish fabrikës së fermentimit të duhanit, Fier"; në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim; në QKB; në mjediset e Drejtorisë Qendrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të web të ISHPSHSH-së.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes. Kundër Procesverbalit të Inspektimit, subjekti ""USAlb & Co"" SHPK ka të drejtën e ankimit me shkrim apo me gojë brenda 8

Adresa : Lagjia Rilindja, Rr. Riza Salati, Vlorë

e-mail: tereza.lacaj@sh.gov.al

ditëve nga data e njoftimit të Procesverbalit të Inspektimit. Ankimi i paraqitet pranë ISHPSHSH-së Vlorë, Rajoni II, Sektori i Inspektimit Fier.

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Procesverbalit të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë ISHPSHSH-së Vlorë, Rajoni II, Sektori Inspektimit Fier, me adresë "Lagjia 16 Prilli, Rruga Llukan Toska, pranë ish fabrikës së fermentimit të duhanit, Fier".

Ky njoftim shpallet sot më datë 16 .09.2026 dhe do të qëndrojë i afishuar deri në datë 26 .09.2026 në mjediset e ISHPSHSH-së dhe në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim.

KRYEINSPEKTORI RAJONAL

Tereza Laçaj

